

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7861
E martë, 13 gusht 2024
Çmimi 0.50

Gruda i PDK-së:
Vetëvendosja ka dorë në
moszbardhjen e rastit të
Astrit Deharit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



SHQIPTARËT NË LUGINË TË PRESHEVËS PROTESTOJNË NË BUJANOC
KUNDËR PADREJTËSIVE NGA SERBIA

SHQIPTARËT E LUGINËS PROTESTOJNË PËR 'IDENTITET DHE DINJITET'

FAQE 3



Shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë protestuar të hënën në Bujanoc. Ata e kanë akuzuar Serbinë për shkeljen sistematike të të drejtave të tyre. Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, e ka akuzuar

qeverinë serbe për mohimin e të drejtave të shqiptarëve. Ai ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për ndaljen e diskriminimit ndaj shqiptarëve në Luginë. Këtë protestë e ka

mbështetur edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, duke u zotuar se të drejtat e shqiptarëve në Luginë do t'i ngritin në nivelet më të larta ndërkombëtare

LV-ja I AKUZON
TË GJITHË PËR
RASTIN DEHARI,
POR S'E THOTË
ASNJË FJALË PËR
ZHUKJEN E
MOSTRAVE F. 3



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR
NDËRTIMIN E MBI 200 SHTËPIVE NË
KOMUNAT VERIORE F. 6



OPINION

TEK URA, TEK URA, SHËTITNI
O TË PABURRA! F. 9

Shkruan: Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



HAXHIU: PAKOJA E LIGJEVE PËR
REFORMËN NË DREJTËSI PRITET TË
DËRGOHET NË KUVEND BRENDA
SHTATORIT F. 6

OSMANI: NGRITJA E STATUSIT TË
KOSOVËS NË FRANKOFONI, TRIUMF
PËR VLERAT FRANKOFONE F. 5

VAZHDON LYERJA E URËS SË IBRIT,
KFOR-i SHTON PRANINË F. 5

EKONOMI



'RROGAT E VOGLA', QYTETARËT
E KOSOVËS FUTEN NË KREDI
MBI 5 MILIARDË EURO F. 9

SHALA: QEVERIA KURTI E KA
THYER REKORDIN E SHPENZIMEVE
TË LUKSIT F. 9

SPORT

QUEVEN SHKËLQEU NDAJ
DUKAGJINIT, RRËMBEN ÇMIMIN
'YLLI I JAVËS' F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca, Gjermania dhe Britania mbështesin thirrjet për armëpushim në Gaza

PARIS, 12 GUSHT - Liderët e Francës, të Gjermanisë dhe të Britanisë së Madhe i kanë mbështetur thirrjet për një armëpushim në Rripin e Gazës dhe kthimin e pengjeve që po mbahen nga Hamasi - grupi i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja.

Në një komunikatë të përbashkët për media të hënën, ata përkrahën përpjekjen më të re të Shteteve të Bashkuara, Katarit dhe Egjiptit për ndërmjetësimin e një marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës tashmë dhjetëmuajore ndërmjet Izraelit dhe Hamasit në Gaza.

Ndërmjetësit për muaj të tërë janë përpjekur t'i bindin palët të pajtohen për një plan me tri faza, sipas të cilit, Hamasi do t'i lironte pengjet e mbetura izraelite në këmbim të lirimit të të burgosurve palestinezë nga burgjet izraelite, si dhe të tërheqjes së Izraelit nga

Gaza. "Luftimet duhet të ndalen tani, dhe të gjitha pengjet që po mbahen ende nga Hamasi duhet të lirohen. Është nevojë urgjente për popullin e Gazës që ndihmat të durohen papenguar dhe menjëherë", është thënë në komunikatë.

Komunikata është nënshkruar nga presidenti francez Emmanuel Macron, kancelari gjerman Olaf Scholz, dhe kryeministri britanik Keir Starmer.

Javën e kaluar, liderët e Shteteve të Bashkuara, Egjiptit dhe Katarit u kanë bërë thirrje Izraelit dhe Hamasit të takohen për bisedime më 15 gusht, qoftë në Katar apo Doha, për finalizimin e një marrëveshjeje.

Izraeli ka thënë se do t'i dërgojë negociatorët e vet për të marrë pjesë në atë takim.

Hamasi ka thënë fillimisht se po e shqyrtonte ofertën, por tani ka



lënë të kuptohet se mund të mos marrë pjesë nëse bisedimet nuk bazohen në planin e presidentit amerikan, Joe Biden.

Kohëve të fundit është rritur edhe rreziku për një luftë të gjerë në Lindjen e Mesme, pas vrasjes në Teheran të liderit politik të Hamasit, Ismail Haniyeh, si dhe

komandantit të lartë ushtarak të Hezbollahit, Faud Shukur, në Bejrut.

Hamasi e ka akuzuar Izraelit për vrasjen e Haniyehut. Izraeli nuk e ka marrë përgjegjësinë, por as nuk e ka mohuar atë.

Irani dhe Hamasi janë zotuar se do të hakmerren kundër Izraelit për

vrasjen e Haniyehut në Teheran. Izraeli ka thënë se synimi i tij është ta shkatërrojë Hamasin pas sulmit të 7 tetorit, në të cilin militantët nga Gaza ishin futur vrullshëm në jug të Izraelit dhe kishin vrarë 1 200 njerëz si dhe rrëmbyer rreth 250 të tjerë.

Pas një raundi këmbimesh në nëntor, Izraeli ka thënë se edhe 111 pengje po mbahen në Gazë, përfshirë trupat e pajetë të 39 pengjeve. Lufta e Izraelit në Gazë prej atëherë i ka lënë të vdekur rreth 40 000 palestinezë dhe më shumë se 91 700 të tjerë të plagosur, sipas zyrtarëve shëndetësorë në enklavë. Më shumë se 1.9 milion e popullsisë së përgjithshme prej 2.3 milionë banorësh e Gazës së paraluftës janë detyruar të ikin nga shtëpitë e tyre, duke u zhvendosur vazhdimisht nëpër territorin e vogël për t'i ikur luftës.

ShBA-ja njofton për dërgimin e një nëndetëseje në Lindjen e Mesme

UASHINGTON, 12 GUSHT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, ka urdhëruar dërgimin e një nëndetëseje me raketa të telekomanduara në Lindjen e Mesme, ka njoftuar Pentagoni.

Druajtjet për sulme të mundshme nga Irani dhe aleatët e tij janë rritur në Lindjen e Mesme, pas vrasjes së liderëve të lartë të Hezbollahit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Në një njoftim për medie pas bisedës mes Austinit dhe homologut të tij izraelit, Pentagoni ka thënë se Austini ka urdhëruar që aeroplanmbajtësi "Abraham Lincoln" ta



përsheptojë dislokimin në rajon. "Sekretari Austin e përsëriti përkushtimin e Shteteve të Bashkuara për ta ndërmarrë çdo hap për ta mbrojtur Izraelin dhe nënvizoi përforsimin e pranisë së ushtrisë dhe armëve amerikane në Lindjen e Mesme pas përshkallëzimit të tensioneve rajonale", është thënë në njoftim. Më herët, ushtria amerikane kishte njoftuar për zhvendosjen shtesë të avionëve luftarakë dhe luftanijeve në Lindjen e Mesme, pasi Uashingtoni synon ta përforsojë mbrojtjen e Izraelit. Ismail Haniyeh, lideri politik i Hamasit, është vrarë në Teheran më 31 korrik, në një sulm i cili ka nxitur kërcënime për hakmarrje nga Irani ndaj Izraelit. Irani e ka

fajësuar Izraelin për vrasjen e tij. Izraeli nuk e ka marrë përgjegjësinë, por as s'e ka mohuar atë. Vrasja e Haniyehut dhe e Fuak Shukur, komandantit të lartë të grupit militant të mbështetur nga Irani, Hezbollah, i ka rritur shqetësimet se konflikti në Gazë mund të shndërrohet në një luftë të gjerë në Lindjen e Mesme.

Irani ka thënë se ShBA-ja ka përgjegjësi për vrasjen e Haniyehut për shkak se ajo e mbështet Izraelin. Ndërkohë, disa anëtarë të personelit amerikan janë plagosur si pasojë e një sulmi kundër një baze ushtarake amerikane në Irak, kanë thënë tre zyrtarë amerikanë për agjencinë e lajmeve "Reuters" më 5 gusht.

Mijëra qytetarë evakuohen teksa zjarret kërcënojnë Athinën

ATHINË, 12 GUSHT - Mijëra persona që jetojnë përreth Athinës janë evakuuar të hënën, më 12 gusht, përfshirë edhe nga qyteza historike Maraton, pasi një zjarr i madh i është afuar kryeqytetit grek, pavarësisht përpjekjeve "mbinjerëzore" për ta vënë në kontroll, thanë zyrtarët.

Autoritetet kanë urdhëruar të paktën edhe pesë komunitete të tjera që të evakuohen dhe dy spitale në verilindje të Athinës, pasi paraprakisht kishin urdhëruar evakuimin e banorëve nga tetë fshatra, përfshirë nga Maraton të dielën.

Kryetari i Maratonës, Stregios Tsirkas, ka thënë se qyteza, nga e cila ka marrë emrin edhe gara e vrapimit në distancë të gjatë, po

përballet me "katastrofë biblike". Një mur i gjatë flake prej 30 kilometrash, dhe në disa vende deri në 25 metra i lartë, po lëvizë drejt Athinës, sipas transmetuesit publik ERT.

Tetë persona janë hospitalizuar pas telasheve me frymëmarrje dhe autoritetet kanë hapur stadiumin olimpiq në veri të Athinës për t'i strehuar të evakuuarit.

"Forcat e mbrojtjes civile kanë punuar gjatë gjithë natës dhe pavarësisht përpjekjeve mbinjerëzore, zjarri është përhapur me shpejtësi", ka thënë zëdhënësi i zjarrfikësve, Vassilis Vathrakogiannis.

Shkatërrimet nga zjarri sjellin në kujtesë zjarrin e korrikut të vitit



2018 në Mati, kur vdiqën 104 persona. Për këtë tragjedi, më pas u tha se faji ishte për shkak se urdhrat për evakuim ishin lëshuar me vonesë.

Sezoni i zjarreve gjatë kësaj vere në Greqi ka shkaktuar dhjetëra zjarre

në baza ditore, teksa shteti ka regjistruar dimrin më të nxehtë dhe qershorin dhe korrikun më të nxehtë që kur ka nisur të mbledhë të dhëna më 1960.

Temperaturat përreth Athinës priten të arrijnë në 39 gradë celsius

të hënën, teksa erërat do të fryjnë deri në 50 kilometra në orë.

Më shumë se 670 zjarrfikës me 183 makina dhe 32 avionë janë angazhuar për t'i shuar zjarret.

Një ditë më herët, ministri i Mbrojtjes Civile, Vassilis Kikilias, ka thënë se shteti është në rrezik të lartë për shkak të temperaturave të larta, erërave të fuqishme dhe thatësisë së madhe.

Shkencëtarët kanë thënë se emetimet e karburanteve fosile po përkeqësojnë gjatësinë, shpeshtësinë dhe intensitetin e valëve të të nxehtëit në mbarë botën.

Edhe pjesë të tjera të botës po përballen me zjarre, teksa disa pjesë të Evropës këtë javë do të përballen me temperatura të larta.

AGK-ja i reagon Sami Kurteshit: Deklaratë e papërgjegjshme dhe e rrezikshme

PRISHTINË, 12 GUSHT - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka reaguar për sulmin e zyrarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ndaj medieve për rastin Astrit Dehari.

AGK-ja ka thënë se deklaratimet e Sami Kurteshit janë të papërgjegjshme dhe të rrezikshme. "Anëtari i Vetëvendosjes në KQZ, Sami Kurteshi, ka sulmuar mediet gjatë një prononcimi sot për rastin e aktivistit të kësaj partie, Astrit Dehari.

Kurteshi ka akuzuar 'Klan Kosovën', 'Expressin' dhe 'RTK'-në: 'për rol negativ dhe dezinformues, sidomos me nxjerrjen e xhirimeve të paautorizuara. Në atë kohë RTK-ja mbulonte gjithë propagandën kundër Lëvizjes Vetëvendosje dhe arsyetonte arrestimet'. Kjo është një deklaratë e papërgjegjshme dhe e rrezikshme e Kurteshit, që akuzon mediet në lidhje me rrethanat e vdekjes në burg të Deharit. Deklarata të tilla vënë

në rrezik sigurinë e gazetarëve të këtyre dy medieve dhe janë të papranueshme. Rasti Dehari ishte dhe mbetet me interes të lartë për publikun, dhe në atë kohë specifikat e atij rasti ishin ndarë në detaje nga vetë Lëvizja Vetëvendosje. Xhirimet e publikuara nga mediet kanë zbuluar rrethanat e ngjarjes në qendrën e paraburgimit ku pritej siguri e lartë, dhe ka kontribuar në informimin e publikut", është thënë në reagimin e AGK-së.



Gruda i PDK-së: Vetëvendosja ka dorë në moszbardhjen e rastit të Astrit Deharit

PRISHTINË, 12 GUSHT - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, i ka kërkuar qeverisë t'i ndalë "lojërat dhe propagandën politike" me rastin Dehari, teksa ka thënë se Vetëvendosja ka dorë në moszbardhjen e këtij rasti.

Gruda në një konferencë për medie e ka quajtur "show politik" dhe vazhdimësi të keqpërdorimit të rastit Dehari, konferencën e Lëvizjes Vetëvendosje të hënën para Prokurorisë Speciale. "Janë bërë më shumë se tri vjet që Lëvizja Vetëvendosje është në pushtet dhe nuk ka bërë asnjë hap për ta zbardhur të vërtetën e rastit Dehari, përkundër premtimeve për zbardhjen e tij sa ishin në opozitë. Përkundrazi, gjatë qeverisjes së Vetëvendosjes janë zhdukur e janë kthyer pjesërisht mostrat e Astrit Deharit dhe është djegur dy herë Instituti i Mjekësisë Ligjore, ku ato ruheshin. Po ashtu, ka disa muaj që LV-ja po e pengon themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me zjarrin në Institut dhe humbjen e mostrave", ka thënë ai.

Gruda ka ngritur një sërë pyetjesh lidhur me këto ngjarje, duke thënë se janë problem të themelor i pushtetit. "Kush i zhduk mostrat e Astrit Deharit në Institut? Kush i



ktheu mostrat e Astrit Deharit në Institut? Kush e dogji Institutin? Si ndodhi që mostrat e Deharit u zhdukën në mars të 2023-s dhe po në atë muaj ndodhi zjarri i parë në Institut? Pas zjarrit të dytë u dogji sistemi i kamerave në IML dhe për katër ditë me radhë nuk kishte fare

vëzhgim të dhomës së dëshmive ku mbahen mostrat e Deharit. Si është e mundur që pikërisht në këtë interval kohor 4 ditor të gjendeshin dhe të ktheheshin mostrat e Astrit Deharit në Institut? Cilat janë masat që janë marrë ndaj personave përgjegjës për

monitorimin e kamerave dhe atyre që kanë çelësin për hyrje në Dhomën e Dëshmive në IML? Pse po e pengoni themelimin e Komisionit Hetimor për rastin Dehari?", ka pyetur Gruda. PDK-ja ka kërkuar që qeveria t'i kthehet sa më parë punës në

zbardhjen e së vërtetës për rastin Dehari. "Po ashtu, dua t'i siguroj të gjithë qytetarët e Kosovës se ky rast nuk do të mbetet i pazbardhur dhe se njerëzit e këtij pushteti që po e pengojnë zbardhjen e tij një ditë do të japin llogari para drejtësisë", ka thënë Gruda.

LV-ja i akuzon të gjithë për rastin Dehari, por s'e thotë asnjë fjalë për zhdukjen e mostrave

PRISHTINË, 12 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje ka implikuar Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Policinë e Kosovës dhe prokurorinë për arrestimet e aktivistëve të saj lidhur me sulmin kundër Kuvendit të Kosovës, ndërsa urdhri, sipas saj, ka ardhur nga ish-presidenti Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentari Kadri Veseli.

Në një konferencë për medie, përfaqësuesi i këtij subjekti politik në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Sami Kurteshi, ka deklaruar se ky rast është bërë me urdhër politik dhe inskenim për t'i fshehur autorët e vërtetë të këtij rasti. "Më 4 gusht 2016 ndodhi sulmi me predhë në

ndërtesën e Kuvendit. Ky ishte inskenimi i sulmit të armatosur mbi ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, duke fshehur autorët e vërtetë dhe fajësimi i LV-së me qëllime të caktuara politike. Prej datës 5 gusht 2016 deri më 25 gusht, sipas Policisë së Kosovës, janë hetuar 4 persona krejtësisht të tjerë. Më 29 gusht 2016 arrestohet Astrit Dehari bashkë me 5 aktivistë të tjerë të LV-së për këtë sulm", ka thënë Kurteshi, duke shtuar se arrestimet kishin ndodhur për ta penguar protestën kundër demarkacionit.

"Ky arrestim ndodhi për ta parandaluar dhe penguar protestën e opozitës më 1 shtator 2016 para parlamentit

të Kosovës kundër demarkacionit. Me urdhër politik nga maja e shtetit të involvuar ishin AKI, Policia, prokuroria dhe gjykata, ku prokurori Abdurrahim Islami para pensionimit kërkon arrestimin e aktivistëve, ndërsa urdhrin e lëshon gjykatësi Vehbi Kashtanjeva, po ashtu pak para pensionimit", ka thënë Kurteshi.

Fillimisht, kjo parti para hyrjes së objektit të prokurorisë ka vendosur disa pankarta ku është kërkuar përgjegjësi e drejtësi për Deharin. Krahas akuzave, zyrtarët e Vetëvendosjes nuk e kanë thënë asnjë fjalë për zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit në Institutin e Mjekësisë Ligjore.





SHQIPTARËT NË LUGINË TË PRESHEVËS PROTESTOJNË NË BUJANOC KUNDËR PADREJTËSIVE NGA SERBIA

Shqiptarët e Luginës protestojnë për “identitetet dhe dinjitetet”

Shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë protestuar të hënën në Bujanoc. Ata e kanë akuzuar Serbinë për shkeljen sistematike të të drejtave të tyre. Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, e ka akuzuar qeverinë serbe për mohimin e të drejtave të shqiptarëve. Ai ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për ndaljen e diskriminimit ndaj shqiptarëve në Luginë. Këtë protestë e ka mbështetur edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, duke u zotuar se të drejtat e shqiptarëve në Luginë do t'i ngritin në nivelet më të larta ndërkombëtare

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

BUJANOC, 12 GUSHT - Banorë shqiptarë nga Lugina e Preshevës në jug të Serbisë kanë protestuar të hënën për “identitetet dhe dinjitetet”, duke e akuzuar qeverinë serbe për diskriminim ndaj tyre. Ata kanë protestuar në Bujanoc duke mbajtur në duar flamuj kombëtarë shqiptarë dhe amerikanë, si dhe pankarta me mbishkrimin “Stop pasivizmit selektiv”, “Të shtypur po, të nënshtruar jo” dhe “Kthema

adresën”, si dhe të veshur me fanella me mbishkrimin “Për identitetet dhe dinjitetet”.

Përfaqësuesi i komunitetit shqiptar në jug të Serbisë, Shaip Kamberi, e ka akuzuar qeverinë serbe për mohimin e të drejtave të pakicës shqiptare, duke thënë se ajo “nuk dëshiron integrimin e tyre në organet shtetërore në mënyrë të drejtë dhe të barabartë”.

Protesta është thirrur të shtunën nga kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Nevzad Lutfiu, nëpërmjet një postimi në

“Facebook”, me sloganin “Për identitetet dhe dinjitetet”.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, shqiptarët janë pakica e katërt më e madhe në Serbi, përkatësisht në këtë shtet jetojnë 61 687 shqiptarë. “Beogradi vazhdon avazin e vjetër, t'i trajtojë shqiptarët si armiq, si popull të rendit të dytë, i cili nuk meriton pjesëmarrje institucionale. Ka vazhduar diskriminimin duke mos i njohur diplomat, mosintegrimin dhe pasivizimin”, ka thënë Kamberi. Kamberi, i cili e ka fituar edhe një

mandat në Kuvendin e Serbisë gjatë zgjedhjeve serbe të 17 dhjetorit, i ka bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për, siç ka thënë, ndaljen e diskriminimit ndaj shqiptarëve në Luginë.

“Ftoj qeverinë që të fillojë në mënyrë urgjente dhe të pakushtëzuar realizimin e obligimeve të marra nga marrëveshjet e nënshkuara, mbi të gjitha ftoj bashkësinë ndërkombëtare të reagojë sa më shpejt për ta ndërprerë aparteidin dhe diskriminim klasik, sepse që nga marrëveshja e Konçulit 2001 e deri te plani 7 pikës 2013, ne kemi pasur besim jo në Beogradin, por në vlerat demokratike perëndimore”, ka thënë Kamberi.

Marrëveshja e Konçulit është arritur në vitin 2001 për çmilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës,

Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) dhe për integrimin e pakicës shqiptare përmes një procesi demokratik.

Në korrik 2013, qeveria e presidentit Aleksandër Vuçiq e ka miratuar planin shtatëpikësh, i cili ishte pothuajse i njëjti si marrëveshjet e mëparshme.

Kamberi e ka lënë të hapur mundësinë për protesta të tjera pas kësaj. Në sheshin ku është mbajtur protesta është parë një numër i madh i policëve me uniformë dhe veshje civile. Nuk është raportuar për ndonjë incident gjatë protestës.

Përfaqësuesit e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit – komuna që njihen edhe me termin Lugina e Preshevës – shpesh janë ankuar se diskriminohen nga autoritetet në Serbi.

Në fund të vitit të kaluar ata janë ankuar për një rritje të numrit të

Vazhdon lryerja e urës së Ibrit, KFOR-i shton praninë

MITROVICË, 12 GUSHT - Punimet në urën e Ibrit kanë vazhduar edhe të hënën, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për hapjen e saj. Punëtorët e kompanisë së angazhuar me tender nga qeveria janë duke e lryer urën që gati një javë. Pas këmbëve dhe mureve nën urë, të hënën ata i kanë lryer edhe "bedenat" dhe pjesë të tjera mbi urë. Ndërkohë është vërejtur prani

e shtuar e KFOR-it. Rreth mesditës, së paku tri vetura të karabinierëve italianë ishin "stacionuar" mbi urë dhe vëzhgonin situatën. Të enjten është bërë testimi i qëndrueshmërisë së urës mbi lber në Mitrovicë. Për këtë qëllim mbi urë kanë qëndruar kamionë të rëndë ndërkohë që gjithë aksioni është "inspektuar" nga ministra dhe

zyrtarë të tjerë në praninë e medieve. Një raport mbi kapacitetin mbajtës të urës, sipas Ministrisë së Mjedisit, pritet të dalë këto ditë, pasi është bërë testimi me kamionë të ngarkuar rëndë. Hapjen e urës e kanë kundërshtuar ShBA-ja dhe BE-ja, duke e cilësuar vendim të njëanshëm të qeverisë Kurti.



Osmani: Ngritja e statusit të Kosovës në Frankofoni, triumf për vlerat frankofone



PRISHTINË, 12 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesin e Organizatës Ndërkombëtare të Frankonisë (ONF) për Evropën Qendrore dhe Lindore, Eric Pope, i cili ka vizituar Kosovën pas aplikimit të Republikës sonë në këtë organizatë.

Presidentja Osmani ka riafirmuar përkushtimin e Kosovës ndaj vlerave frankofone, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së statusit të Kosovës në ONF nga statusi i vëzhguesit në anëtar me të drejta të

plota. Osmani ka theksuar se Kosova është shembull i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve pa dallim, forcimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. "Rinia është potenciali më i madh i Kosovës dhe me talentin e dëshmuar në ndërmarrësi dhe inovacion, është shembull për rajon e më gjerë", ka thënë Osmani, duke e njoftuar Popen edhe për avancimin e agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë, ku Kosova është shndërruar në shembull pozitiv në

nivel global. Në këtë frymë, presidentja Osmani ka theksuar se përmes ngritjes së statusit të Kosovës në ONF do të thellohet bashkëpunimi me shtete të tjera anëtare në zhvillim të qëndrueshëm, promovimin e diversitetit kulturor e gjuhësor, arsim e hulumtime shkencore, si dhe në fusha të tjera të interesit të ndërsjellë. Presidentja Osmani dhe Pope kanë diskutuar edhe për samitin e Frankonisë në tetor, ku Osmani do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës.

çaktivizimit të adresave të tyre nga policia serbe, duke e akuzuar atë se i ka fshirë ato në mënyrë të paligjshme, për t'ua mohuar të drejtat elementare.

Problemi i çaktivizimit të adresave është përmendur në raportin e Komisionit Evropian për Serbinë më 2022, në pjesën që ka të bëjë me respektimin e të drejtave të pakicave.

Bislimi mbështet protestën në Bujanoc: Serbia në vazhdimësi shkel të drejtat e shqiptarëve

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka reaguar pas protestës së shqiptarëve në Bujanoc. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës mbështet shqiptarët e Luginës së Preshevës të cilët, sipas tij, vazhdojnë të përballen me një situatë të papranueshme diskriminimi sistematik, që cenon të drejtat e tyre themelore. Bislimi ka thënë se kërkesa e tyre për respektimin e marrëveshjeve politike, ndalimin e pasivizimit të



adresave, njohjen e diplomave të Kosovës dhe përfshirjen e drejtë në institucionet shtetërore janë plotësisht legjitime dhe të drejta. "Shqiptarët e Luginës së Preshevës vijojnë të përballen me një situatë të papranueshme diskriminimi sistematik, që

cenon të drejtat e tyre themelore. Kërkesat e tyre për 'respektimin e marrëveshjeve politike, ndalimin e pasivizimit të adresave, njohjen e diplomave të Kosovës dhe përfshirjen e drejtë në institucionet shtetërore' janë plotësisht legjitime dhe të drejta.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbështet bashkëkombësit tanë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë si dhe mbetet e angazhuar për të ngritur këto çështje në nivelet më të larta ndërkombëtare dhe të kërkojë përkrahje për t'i dhënë fund

diskriminimit të padrejtë. Zgjidhja e këtyre çështjeve është dëshmi edhe për përkushtimin ndaj demokracisë dhe të drejtat e njeriut, e cila mungon nga fqinji ynë verior, që në vazhdimësi shkel të drejtat e komunitetit shqiptar", ka shkruar Bislimi në "Facebook".

Edona Maloku emërohet ambasadore e Kosovës në Portugali

PRISHTINË, 12 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se e ka emëruar Edona Malokun ambasadore të Kosovës në

Portugali. Në platformën "X", Osmani ka thënë se është e kënaqur me emërimin që e ka bërë, duke e quajtur Malokun akademike

dhe profesioniste e dalluar. "Jam e bindur se njohuritë dhe angazhimi i saj do të jenë të paçmueshme, ndërsa punojmë drejt thellimit të

lidhjeve të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe aleates sonë - Portugalisë", ka thënë Osmani.



Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e mbi 200 shtëpive në komunat veriore

PRISHTINË, 12 GUSHT - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka bërë me dije se është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e mbi 200 shtëpive në katër komunat veriore të Kosovës. Kjo, sipas Krasniqit, është bërë në bashkëpunim me kryetarin e shoqatës "Jetimat e

Ballkanit", Halil Kastratin. "Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shoqata 'Jetimat e Ballkanit', në frymën e bashkëpunimit dhe sigurimit të banimit të qëndrueshëm, për banorët e komunave veriore do të ndërtojnë mbi 200 shtëpi duke u dhënë të drejtë familjeve ta realizojnë

ëndrrën e tyre për të banuar dhe jetuar në tokat e tyre. Mbi 100 shtëpi do të ndërtohen me financim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe mbi 100 nga shoqata 'Jetimat e Ballkanit', si fillim për një jetë të re për këto familje", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



Haxhiu: Pakoja e ligjeve për reformën në drejtësi pritet të dërgohet në Kuvend brenda shtatorit



PRISHTINË, 12 GUSHT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka takuar të hënën krerët e institucioneve të drejtësisë lidhur me reformën në drejtësi, në të

cilin takim kanë qenë përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor, Gjykatës Supreme dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Ministria e Drejtësisë ka

njoftuar se përkundër ftesës për përfaqësuesit e sistemit prokurorial, ata kanë munguar në takim. Në fjalën e saj, ministria Haxhiu

ka bërë me dije se pakoja e ligjeve që rrjedhë nga Deklarata e përbashkët e zotimeve në mes të institucioneve të drejtësisë pritet të dërgohet në Kuvend

brenda muajit shtator në mënyrë që të përmbyllet reforma në drejtësi.

Më tutje, ministria Haxhiu ka kërkuar që në afat sa më të shpejtë, aktorët e reformës në drejtësi t'i përcjellin komentet e fundit mbi aktet e finalizuara në mënyrë që të diskutohen dhe adresohen në punëtorinë e fundit e cila planifikohet të mbahet në fillim të muajit shtator. "Edhe njëherë shprehu vullnetin tim si ministre e Drejtësisë për ta adresuar sa më shpejt dhe profesionalisht reformën në drejtësi", ka thënë ministria Haxhiu.

Gjatë diskutimit, përfaqësues të sistemit gjyqësor dhe partnerët ndërkombëtarë kanë shprehur mirënjohjen për arritjet e deritanishme në këtë proces të rëndësishëm reformues, gjithashtu duke u shprehur të gatshëm për kontributin dhe mbështetjen në finalizimin e akteve përkatëse normative.

Në fund ministria Haxhiu ka thënë se në këtë proces ka qenë i rëndësishëm angazhimi i përbashkët për përmbylljen e obligimeve që rrjedhin nga Deklarata e përbashkët e zotimeve për çfarë i ka falënderuar të gjithë aktorët kontribuues, ndërsa ka shprehur indinjatën e saj për mungesën e vullnetit të KPK-së për ta realizuar reformën në drejtësi.

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve

PRIZREN, 12 GUSHT - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit K. O. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 267, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, i pandehuri K. O. me datë 22.05.2024 rreth orës 20:35, në vendkalimin kufitar të pikës kufitare në Vermicë, duke hyrë në

Kosovë nga Republika e Shqipërisë, pa autorizim ka poseduar narkotikë të llojit "marihuanë" me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të tij nga ana e policisë, në veturën "Honda Jazz", të cilën veturë ishte duke e vozitur i pandehuri, e pikërisht në brendësi të motorit të veturës, policia ka gjetur dhe sekustruar një (1) qese najloni të tejdukshme me substancë narkotike të llojit

"marihuanë" në peshë 86.89 gramë, ndërsa në trup të tij është gjetur një qese najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit "marihuanë" në peshë 0.90 gramë, e për transportin e së cilës substancë narkotike nuk ka pasur autorizim përkatës. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.



Nga "Gucci" e deri te detergjenti, Kosova treg për shumë produkte false

PRISHTINË, 12 GUSHT - Lu deshën disa muaj dhe një udhëtim për në Gjermani për të kuptuar se një palë atlete "Nike" që i kushtuan rreth 100 euro në Kosovë, ishin false. Vesa (identiteti i plotë i njohur për redaksinë) ka treguar se këpucët i kishte blerë nga një faqe online, duke menduar se janë origjinale.

"Një koleg/shok i punës më pati thënë se i ke false dhe më rekomandoi t'i ndërroj dhe t'i blej të tjera në Gjermani", ka treguar ajo, duke shtuar se më pas i ka krahasuar atletet e saj me ato në Gjermani. Ajo ka thënë se më nuk ka pasur vullnet të merret me faqen që ia shiti atletet veçse ngjarja ia shtoi mosbesimin për produktet që shiten në Kosovë.

Nëpër dyqane të Kosovës, përfshirë ato në qendër të kryeqytetit, shiten pa ndonjë telash produkte me marka të njohura botërore, por me cilësi dhe çmime të dyshimta.

"Tridhjetë e nëntë (39) euro", është përgjigjur shkurt shitësi kur është pyetur për çmimin e një palë sandaleve të ekspozuara në një nga dyqanet e lagjes "Dardania" të Prishtinës.

Në thembrën e sandaleve që mbajnë markën "Gucci", brendi i njohur luksoz nga Italia, madje shkruhet se ato janë prodhuar në Itali.

"Vijnë nga Turqia", ka thënë shitësi për "Radion Evropa e Lirë" kur është pyetur për prejardhjen e sandaleve, pa dhënë detaje të tjera. Me pak dallime në dizajn dhe shumë dallim në çmim, këto sandale mund të gjenden në faqen zyrtare të kompanisë "Gucci", marka e së cilës është e mbrojtur në shumë vende të botës, përfshirë në Kosovë, çmimi i të cilave është disa qindra euro.

Përveç "Guccit", të ekspozuara hapur nëpër shumë dyqane të Prishtinës shihen veshje, çanta, aksesore e këpucë të markave të njohura botërore, nga "Luis Vitton" e deri te "Nike" e "Adidas". Çmimet variojnë nga 5 deri në 40 euro.

Riprodhimi apo shitja e imitimeve të markave të njohura botërore pa autorizim nuk ishte e rregulluar apo e ndaluar me ligj në Kosovë deri në vitin 2011, kur legjislacioni i vendit nisi të harmonizohet me atë të Bashkimit Evropian. "Para se të kishim një legjislacion, këto mallra kanë hyrë lirshëm sepse nuk kemi pasur ndonjë mandat ligjor (për ndalimin e tyre)", ka thënë Sadije Topojani, udhëheqëse e Departamentit për Mbrojtjen e Pronës Intelektuale në Doganën e Kosovës.

Dogana që tani luan rol kyç në ndalimin e mallrave të falsifikuara apo mbrojtjen e markave tregtare, ka thënë se mënyrat e futjes së këtyre mallrave po bëhen gjithnjë e më kreative.

Dogana bën kryesisht ndalimin e mallrave gjatë tentimit për import, por ka kompetenca edhe për kontrollimin e shitësve brenda vendit.

"Shkelësit, edhe gjatë hyrjes në



kufi, i përziejnë me mallra tjera, duke mos i deklaruar, duke tentuar ta vënë në lajthitje institucionin. Gjithashtu, tentojnë edhe përmes stikerëve të fshehin markat tregtare, e deklarojnë mallin si pa markë tregtare", ka thënë Topojani.

Nga dhe si po hyjnë këto mallra?

Statistikat e Doganës së Kosovës e rendisin Turqinë si vendin më të shpeshtë të origjinës së mallrave të falsifikuara që kapen në Kosovë gjatë tentimit për import, por edhe brenda vendit.

Ndërkaq, kufiri me Maqedoninë e Veriut konsiderohet si pika ku më së shpeshti kontrabandohen këto mallra. "Radio Evropa e Lirë" ka gjetur dhe analizuar disa raste të kapjes së mallrave të falsifikuara që u gjykuan nga Gjykata Komeriale në Kosovë. Ishte 24 tetori i vitit 2022, kur një mjet transportues i mallrave i kompanisë "Selo Tours" nga Prishtina ishte ndaluar në Doganën e Kosovës.

Në kontingjentin e mallrave që po importoheshin nga Turqia, kësaj kompanie i ishin gjetur edhe 88 palë këpucë dhe rreth 50 kapele me markën "Adidas".

Pasi kompania "Adidas" kishte vërtetuar se produktet ishin false, Gjykata Komeriale në Prishtinë e kishte dënuar këtë kompani me 5 mijë euro dhe e pati urdhëruar shkatërrimin e këtyre mallrave.

Në po të njëjtën ditë ishin kapur edhe 245 çanta të markës "Michael Kors", po ashtu të falsifikuara. Edhe për këto produkte, kompania ishte dënuar nga gjykata me 5 mijë euro.

Sami Janova, pronar i kompanisë transportuese i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se ka qenë viktimë e tregtarëve që kanë bërë porosinë e mallit pa treguar se shkelin markën tregtare. "Ne jemi transportues, tregtarët i kanë futur aty. Tregtarët na kanë mashtruar, i kanë futur në thasë. I blejnë në Turqi, i përziejnë me mallra të tjera", ka thënë Janova.

Janovaka thënë se futja e mallrave në këtë formë, sidomos nga Turqia, bëhet shpesh nga tregtarët e vegjël në Kosovë. "Tregtari nuk e tregon realitetin se ka marka (të falsifikuara). Thotë se është mall tjetër, e ne nuk mund t'i kontrollojmë të gjitha", ka thënë Janova.

Ai ka theksuar se ka kërkuar llogari nga tregtarët dhe ata ia kanë paguar dënimet nga gjykata. Kompania e tij ishte dënuar po ashtu për shkak të disa qindra kapelave dhe dhjetëra palltove të markës "Moncler", që kishte tentuar t'i importonte më 21 tetor të vitit 2022. Kompania italiane kishte vërtetuar në gjykatë se produktet ishin të falsifikuara.

Avokati Florin Lata i cili me firmën e tij ligjore "Vokshi & Lata", përfaqëson në gjykatë disa kompani të njohura botërore, ka thënë se produktet e falsifikuara po bëhen gjithnjë e më vështirë për t'u identifikuar. "Jo çdoherë çmimi mundëson identifikimin e një produkti të falsifikuar pasi që shpesh herë ato shiten me çmime të larta. Kemi vërejtur kohëve të fundit që ka produkte të falsifikuara që shiten me çmime shumë të larta, e që janë produktet e tekstilit", ka thënë Lata.

Sipas tij, përveç doganës, për luftimin e falsifikimit duhet të angazhohet më shumë edhe Inspektorati i Tregut. "Inspektorati duhet të rrisë kapacitetet njerëzore. Po ashtu, duhet që të vazhdojnë trajnimet e specializuara për të gjithë aktorët, si gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e doganës, policisë dhe inspektoratit, sepse teknikat që falsifikatorët dhe kontrabandistët i përdorin janë mjaft të sofistikuar", ka thënë Lata.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar Inspektoratin e Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë për koment lidhur me këtë çështje, por nuk ka marrë përgjigje. Por, nuk janë vetëm veshmbathjet e falsifikuara që arrijnë tregun kosovar.

Sipas statistikave doganore, mallra të falsifikuara variojnë nga

teknologjia, produktet ushqimore, të higjienës, veshmbathjet, aksesoret e deri tek ato kozmetike. Shembull, rreth 4 mijë thasë me detergjent të markës "Ariel", markë e njohur në tregun e Kosovës, u nisën si import nga Turqia në Kosovë në gusht të vitit 2022.

Importuesit "Cristal Group Ris", i është ndaluar ky mall nën dyshimin se nuk është origjinal. Çështja kishte përfunduar në gjykatë ku kompania "The Procter & Gamble Company" që bën prodhimin e detergjenteve në fjalë kishte vërtetuar se produkti i kapur nga Dogana e Kosovës ishte i falsifikuar.

Kompania kishte arritur në këtë konkluzion pasi kishte identifikuar dallime në disa aspekte në paketimin e jashtëm të produktit si dhe "janë identifikuar gabime drejtshkrimore".

Sipas përfaqësuesit të kompanisë që ka folur me "REL"-in, por që nuk ka dashur t'i përmendë emri, ky vendim është i gabuar dhe produkti që kishte tentuar ta sillte ishte origjinal. "Ne e kemi marrë për origjinal se për fals nuk jemi të interesuar. Këso 'Arieli' si i joni që e kanë ndaluar në doganë, ka pasur në treg (të Kosovës) dhe vazhdon të ketë", ka thënë ai.

Ky importues ka pretenduar se analiza e pamjes së jashtme të thasëve të detergjentit nuk mjafton për vërtetimin e origjinalitetit. "Unë e di që rrobahen me higjienë (detergjent) brenda e jo me qese. Duhet bërë analiza brenda", ka thënë ai, duke shtuar se do të vazhdojë të luftojë vendimin në çdo instancë të mundshme gjyqësore.

Ndonëse dominojnë rastet që lidhen me veshmbathje, në gjykatë janë trajtuar edhe raste të falsifikimeve të aksesoreve, detergjenteve dhe produkteve ushqimore.

Përveç se nga importi, sipas Doganës së Kosovës, në të kaluarën janë kapur edhe mini-fabrika të prodhimit të produkteve të falsifikuara në Kosovë.

"Nga vetë fakti që ne kemi zbuluar shumë logo të markave të njohura

në kontrabandë, të jep të kuptosh se këtu ka prodhim. Nuk është malli i falsifikuar vetëm nga kontrabanda", ka thënë Topojani.

Çështja e mbrojtjes së pronës intelektuale ku hyn edhe ndalesa e falsifikimit të produkteve trajtohet nëpër raporte të progresit të Bashkimit Evropian për Kosovën. Në raportin e vitit 2023 është thënë se Kosova ka bërë një lloj progresi në këtë fushë, por që rekomandohet edhe më shumë punë në zbatimin e ligjit dhe koordinim të institucioneve që merren me këtë fushë.

Dhjetëra lodra që ka identifikuar "Radio Evropa e Lirë" në tregun e Kosovës, nuk i plotësojnë tri kriteret bazë sipas direktivave të BE-së, që duhet të respektohen për t'i importuar dhe vendosur lodrat në treg.

Mënyra se si institucionet verifikojnë nëse një produkt është origjinal apo fals sa herë që ka dyshime, është përmes konfirmimit nga kompania prodhuese.

Disa mënyra të tjera se si ekspertët e fushës rekomandojnë që blerësit të verifikojnë origjinalitetin e produkteve është përmes pamjes së jashtme, cilësisë si dhe çmimit kur kemi të bëjmë me produkte të markave më të shtrenjta.

Po ashtu, rekomandohet që blerja e markave të bëhet vetëm nga faqet zyrtare, dyqanet apo përfaqësitë e regjistruara të markave të ndryshme, apo dyqane që ofrojnë dokumentacione të qarta të origjinës së produkteve apo edhe garanci.

"Është e rëndësishme (verifikimi) pasi që ka raste kur produkti fals është shumë i sofistikuar. Është e dhimbshme për qytetarin, për shembull, nëse paguan për një produkt mbi dyqind euro ose mbi njëqind euro, i cili rezulton i falsifikuar", ka thënë ajo.

Dhimbja e blerjes së produktit fals me çmim të lartë e ka prekur edhe Vesën e cila thotë se tashmë "nuk blen ose nuk porosin (brendë të njohura) në Kosovë". "Përveç kur e di sigurt se është një dyqan tamam", ka thënë ajo.

Udhëzimi administrativ për përcaktimin e rregullave dhe kuotave të importit, goditje shkatërruese për sektorin privat



Shkruan:
Safet GËRXHALJU

Në një kohë kur vëmendja e opinionit publik është përqendruar tek çështja e Urës së Ibrit dhe momenti eventual i hapjes së saj, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka ndërmarrë një hap të rrezikshëm që prek thellësisht sektorin privat. Ministrja e kësaj ministrie ka nënshkruar Udhëzimin administrativ nr. 06/2024, që përcakton rregullat dhe

procedurat për administrimin e kuotave të importit.

Ky udhëzim, i cili kaloi në heshtje dhe pa shumë zhurmë mediatike dhe pa dialog publiko – privat, vendos një kontroll të rreptë mbi sasinë dhe llojin e produkteve që mund të importohen në Kosovë, si dhe mbi kompanitë që kanë të drejtën të kryejnë këto importe. Një qasje e tillë është më e zakonshme në vendet me regjime totalitare dhe bie ndesh me parimet e tregut të lirë që karakterizojnë një ekonomi të hapur si ajo e Kosovës. Dëmet e këtij udhëzimi nuk do t'i ndiejë vetëm sektori privat, por edhe qytetarët dhe ekonomitë familjare. Pasoja të menjëhershme pritet të jenë një valë e re e rritjes së çmimeve, duke e bërë jetesën më të vështirë për shumicën e qytetarëve të Kosovës. Kjo do të

jetë një goditje e rëndë për ekonomitë familjare, veçanërisht pas inflacionit dhe ngritjes së çmimeve që kemi përjetuar gjatë muajve të fundit. Përveç kësaj, ky udhëzim pritet të favorizojë vetëm disa kompani të caktuara dhe oligarkët që mbështesin partinë në pushtet, ndërsa shumë kompani të tjera, përfshirë ato që përfaqësojnë brende ndërkombëtare në vendin tonë, do të përballen me sfida serioze për mbijetesë. Kjo situatë mund të largojë edhe investitorët e huaj, të cilët tashmë janë të pakët ose mungojnë plotësisht në Kosovë, duke krijuar një klimë investimi të pasigurt dhe të papërshtatshme. Ajo që është më shqetësuese është fakti që ky udhëzim është miratuar pa një konsultim paraprak me përfaqësuesit e sektorit privat, të cilët janë ata që

do të preken drejtpërdrejt nga ky rregullim. Kjo tregon qartë se (MINT) është e distancuar nga nevojat dhe sfidat e sektorit privat, duke ndërmarrë vendime që dëmtojnë zhvillimin ekonomik dhe nxisin një mjedis të pafavorshëm për bizneset. Në vend që të përqendrohet në promovimin e investimeve të huaja dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, MINT-i duket se po krijon mekanizma që shtypin tregun e lirë në Kosovë. Kjo është një goditje e rëndë për ekonominë e vendit dhe për perspektivat e zhvillimit të tij në të ardhmen. Është për t'u habitur kur shikon në faqen zyrtare të Ministrisë në rrjetet sociale, përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe organizatave tjera që i bëjnë "like" një postimi të tillë, duke treguar një mungesë të

qartë të mbrojtjes së interesave të biznesit dhe një servilizëm të thellë ndaj çdo qeverie apo ministri. Në anën tjetër, është gjithashtu shqetësues fakti që opozita në Kosovë duket se ka humbur orientimin e saj dhe nuk trajton tema të tilla që do të mund të godisnin qeverinë aktuale dhe t'i detyronin të rimendonin politikat e tyre. Këto janë çështje që duhet të ngrihen nga opozita, për t'i mbrojtur interesat e qytetarëve dhe të sektorit privat, për të parandaluar pasoja që do të vijnë në të ardhmen si rezultat i këtyre vendimeve të papërshtatshme. Pse heshtin asociacionet e bizneseve në Kosovë dhe shoqëria civile për vendime të tilla qeveritare që janë shkatërruese për sektorin privat i cili është shtyllë e funksionimit të Republikës së Kosovës.

'Rrogat e vogla', qytetarët e Kosovës futen në kredi mbi 5 miliardë euro

PRISHTINË, 12 GUSHT - Numri i qytetarëve që kanë marrë kredi nëpër bankat komerciale në Kosovë është rritur mbi 6 mijë deri në qershor të vitit 2024 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Afërsisht 87 mijë qytetarë u janë drejtuar bankave të Kosovës për kredi në gjashtëmuorin e parë. Shuma e përgjithshme e kredive në sektorin bankar deri në muajin qershor është mbi 5 miliardë euro. Njohësit e ekonomisë këtë e vlerësojnë shqetësuese. Derisa norma mesatare e interesit ka shënuar një rënie të lehtë. Përkundër kësaj, qytetarët ankohen për kamatat e larta, për çka thonë se po kanë vështirësi për kthimin e mjeteve. Ata potencojnë se për shkak të pagave të ulëta po detyrohen të marrin kredi.

Qytetari Muhamet Godeni ka thënë se për marrjen e 2 mijë eurove kredi, për shkak të kamatës së lartë, ka kthyer rreth 500 euro më shumë. Ai ka treguar se si rrjedhojë e çmimeve të larta në përgjithësi, ka hasur në vështirësi gjatë pagesave të kësteve. "Kur i kam pas marrë 2 mijë euro kredi, 500 euro gati t'i ndalin kamatat. Nuk ia vlen, si me qenë haraç. A po keni vështirësi në kthimin e kredisë? Po si nuk është vështirë.



Dalin problemet, jeta e shtrenjtë dhe kjo ndikon. Qeveria mund të ndikojë te bankat që mos ta lejojë kamatën e madhe", ka thënë Godeni për "KP".

Edhe Riza Krasniqi, kredimarrës, ka potencuar se kamatat janë shumë të larta. Ai ka vlerësuar se bankat në Kosovë kanë për qëllim varfërimin e popullit dhe jo zhvillimin ekonomik të vendit. "Që nga paslufta janë hapur

shumë banka të cilat nuk janë në shërbim të zhvillimit të ekonomisë dhe mirëqenies qytetare, por kanë për qëllim që popullin shqiptar ta bëjnë të varfër. Çdo kredi merret për ta përmbushur një nevojë të caktuar të individit. Rrogat janë minimale, lëmshë janë. Këto janë rroga për të thënë se po mbijetoj", ka deklaruar Krasniqi.

Ndërsa Eroll Maqedonci, derisa ka

treguar se ka marrë kredi për renovimin e banesës, ka theksuar se është sfiduar në kthimin e mjeteve.

Në anën tjetër, nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) kanë thënë se numri i përgjithshëm i kredimarrësve është 86 mijë e 198 deri në qershor, mbi 6 mijë më shumë se vitin e kaluar në po këtë periudhë. Nga BQK-ja kanë theksuar se shumica e përgjithshme

e kredive në sektorin bankar në gjashtëmuorin e parë të këtij viti është 5.35 miliardë euro. Sipas BQK-së, norma mesatare e interesit për kreditë e reja në muajin qershor 2024 përlogaritet 6.12 për qind, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte 6.50 për qind.

Më tutje, nga Shoqata e Bankave kanë treguar se vlera e kredive të reja të raportuara deri në muajin qershor 2024 është 236.5 milionë euro.

Profesori i ekonomisë, Mustafë Kadrijaj, e ka vlerësuar shqetësues faktin e rritjes së numrit të kredimarrësve. Ai ka thënë se bankat komerciale nuk janë aspak fleksibile ndaj bizneseve dhe qytetarëve. Kadrijaj ka thënë se BQK-ja duhet të veprojë në mënyrë që bankat të jenë më të leverdishme për kredimarrësit.

Përveç rritjes së kredive, edhe depozitat kanë arritur vlerën prej 6.13 miliardë eurosh, duke shënuar rritje për 67.67 milionë euro.

Ndërsa fitimi i pastër i bankave komerciale në vend nga janari deri në maj të këtij viti ishte 73.6 milionë euro, kurse profiti i institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare ishte 8.2 milionë euro gjatë kësaj periudhe, me një normë interesi në kredi 19 për qind.

Shala: Qeveria Kurti e ka thyer rekordin e shpenzimeve të luksit

PRISHTINË, 12 GUSHT - Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, Ferat Shala, ka kritikuar qeverinë Kurti për rritjen e shpenzimeve të udhëtimit.

Shala ka thënë se "fatura" e

pushtetit në luksin qeveritar ka thyer rekordin e të gjitha qeverive të tjera. Shifrën për gjashtëmuorin e këtij viti, prej 5.25 milionë eurosh, të harxhuar për shpenzime, Shala e ka cilësuar shumë të lartë. "Janë shpenzime shumë të larta. Kostoja e qeverisë në luksin

institucional është e lartë si asnjëherë tjetër dhe është rekord i të gjitha qeverive në Kosovë", ka deklaruar Shala për "FrontOnline".

Shala ka thënë se qeveria Kurti ka demantuar premtimet e veta me statistikat e shpenzimeve të udhëtimit. "Qeveria në kohën

e ardhjes në pushtet kishte premtuar reforma të mëdha, zvogëlim të shpenzimeve, zvogëlim në minimum të udhëtimit zyrtar, të veturave dhe pjesëve të tjera të luksit qeveritar, por të gjitha këto janë demantuar nga vetë qeveria dhe statistikat", ka deklaruar Shala.



Te ura, te ura, shëtiti o të pa burra!



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA – BAJGORA

A mund të bëhen udbashët patriotë: Pas përfundimit të luftës në Kosovë, para se të hynin në bisedime me Serbinë, shqiptarët është dashur t'i sqarojnë punët midis tyre për të kaluarën jo shumë të largët. Kjo çështje, në radhë të parë iu ka takuar të burgosurve politikë, si komuniteti më i terrorizuar nga regjimi jugosllav dhe serbian. Mirëpo, si "pasardhës" të Nënës Terezë ua falëm këtë dhunuesve tanë që flisin shqip, në emër të një uniteti të përkohshëm dhe ndërtimit të shtetit.

Unitet, me kënd?! Me udbashët, prokurorë dhe gjykatës të Danica Marinkoviqit, politikanë që qençe i shërbyen Jugosllavisë, bijë dhe bija të kësaj race bastarde tashmë të metastazuara në të gjitha segmentet e shoqërisë kosovare, në veçanti në poste të vendimmarrjes politike dhe aty ku ishte fuqia ekonomike. Në vend që t'ua prenim biletën për Serbi, te gjaku i tyre politik dhe kombëtar, përmes tyre e përligjëm Serbinë në Kosovë duke e bërë faktor të pashmangshëm për të ardhmen e Kosovës. Udbashët e deridjeshëm kidnapuan doktorin e UÇK - së, Hafir Shalën, të burgosurin politikë, Xhavit Hazirin, mbytnë nën torturë Besnik Rastelicën, Rexhep Bislimin dhe shumë patriotë tjerë. Me kalimin e kohës, me fajin tonë ekskluziv, të burgosurit politikë u marginalizuan kurse dhunuesit dhe torturuesit e tyre vetëm sa u fuqizuan. Sidomos në qeverinë Kurti 2 ku janë bërë shumicë absolute në vendimmarrje dhe shkatërrim të shtetit. Nëse e analizoni qeverinë Kurti 2, aty nuk do të gjeni patriotizëm, as si mbetje mortore e lëre më diçka të dukshme apo të prekshme! Duket se edhe Albin Kurti është liruar nga barra e të qenit patriotë, nëse i referohemi bashkëpunëtorëve të ngushtë e që lirisht mund të

konsiderohen si ajka e antikombëtarizmit dhe mendja e shpirti i të kaluarës jugosllave dhe serbe. Sidomos në luftën që e bëjnë kundër UÇK-së, të të burgosurve politikë, veteranëve të UÇK-së dhe drejtuesve kryesorë ushtarakë dhe politikë që po mbahen si pengje të Gjykatës Speciale Raciste në Hagë. Patriotizmi i qeverisë Kurti 2 ka mendësi dhe përmbajtje antikombëtare, edhe ata që, ekskluzivisht për vota dhe poste kanë trashëguar një të kaluar të lavdishme kombëtare, me veprimet e tyre e kanë turpëruar skajshmërisht atë trashëgimi duke u shndërruar në vrasës të paraardhësve të tyre të lavdishëm që krijuan vepra dhe që këta pameritueshëm i trashëguan! Çfarë turpi dhe poshtërsie! Në "TV Dukagjini", përkatësisht në emisionin "Debat Plus" me Ermal Pandurin kemi hyrë në javën e tretë të rrëfimeve të lahtarshme të të mbijetuarve të torturës nga udbashët, prokurorët dhe gjykatësit shqipfolës, në shërbim të Jugosllavisë dhe të Serbisë dhe, deri më sot nuk kemi asnjë reagim institucional, as nga Albin Kurti, Kaçketa e Sfilatistja e Dështuar, si patriotë të vetëdeklaruar në kohën kur nuk kanë lënë pa u deklaruar edhe për gjëra më banale. Sot, dhunuesit e atyre që janë rëfyer dhe do të rrëfihen, lirisht jetojnë dhe mrizojnë në Kosovë duke u ndjerë më rehat dhe më krenarë se pasardhësit e Adem dhe Hamëz Jasharit, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, Ilaz Kodra dhe Remzi Ademaj si dhe të shumë heronjve dhe martirëve të Kombit. Këta keqbërës sot i gjeni në zyrën e KM, në Ministrinë e Xhelalit, në Ministrinë e Lenka Çukos dhe, pa asnjë dyshim, gjithkund dhe gjithkrah ku punohet kundër interesave të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Shihni mediat, shihni tenderët, shihni Hajnullahun e Prizrenit, ua ndanë paratë familjarëve, vetes, partisë dhe hajdutëve të benzinës

ndonëse nuk kishin fare vetura. Shiheni Dil- malin, djalë i bukur, simpatik dhe frenetik. Si e shanë Agim Aliun për një nënkallim madhështor, të denjë edhe për metropolet evropiane kurse, duket të padenjë për një të munguar në kohën kur Zoti ka pajisur krijesat e veta me mend!! Megjithatë, mirë jemi me një numër aq të madh të injorantëve dhe fukarenjve të substancës trurorë. Thënë të vërtetën, vetëm te Albini kam pasur besim se do të bëjë ndryshim. Dhe, e bëri..... Albini nga shumë individë po akuzohet se është rekrutuar nga Serbia dhe se po i zbaton politikat e Serbisë dhe Rusisë në Kosovë. Prijatar i këtyre dyshimeve është Ramush Haradinaj që ishte edhe KM i Kosovës. Përkundër qëndrimit kritik për mos - punën e Albin Kurtit, do të ishte krejtësisht patologjike të besoj se Albini është tradhtar. Thjesht, nuk ma kapë truri sepse nuk dëshiroj të jetë kështu. As në imagjinatën më të paimagjinueshme. Unë kam dyshime të mëdha në këtë drejtim për Besnik Gjylekarin dhe Limoza Kularin - Gadafi. Këtyre nuk iu kam besën për asgjë përveç mercenarizmit.

Grelja që e flet shqipen më mirë se Arbërie Nagavci: Dejona është femra fatale e LVV - së dhe xhoker i antikombëtarëve. Është Laddy Makbeth apo Vejusha e Zezë në Shqipëri dhe Kosovë. I ka pickuar trutharët e LVV-së duke ua injektuar injorancën që me aq liri dhe krenari e shpërfaqin në paraqitjet publike. Po një gjë nuk mund t'i mohohet, shqipen e flet më mirë dhe më rrjedhshëm se Arbërie Nagavci, mendermethënë, ministre e Arsimit <https://gazetametro.net/category/lajme/> qeverinë Kurti 2. Sa poshtë kemi rënë.

A do të hapet ura e Agimit dhe e Milladinit: Ura mbi lumin Ibër që e ndanë Mitrovicën në dysh, të Veriut (Milladin Popoviq) dhe të

Jugut (Agim Tartufi - Matufi) u mbyllë në Rambuje nga francezët. Këta që tërë kohën punuan dhe mbase edhe sot punojnë për Serbinë fajin për këtë ndarje ua lanë UÇK - së dhe komandantëve të saj. Merreni me mend, UÇK dhe komandantët e saj qenka dashur të luftojnë me KFOR- in në qershor të vitit 1999. Deri sa u zgjodh në krye të Mitrovicës intelektual i shquar shqiptar, politikani i përmasave botërore dhe strategu që edhe Napoleonin e shkel për këtë, Agim Bahtiri, nuk kishte përpjekje serioze për hapje të urës. Me fjalime të zjarrta, elokuede dhe magjepsëse, Agim Tartufi (peçurka më e kushtueshme në botë), ia hapi rrugën alter egos politike dhe kombëtare të tij (KM Kurti), që përfundimisht ta hapë urën. Një herë të vjen vera, kah dera. Albini është i vendosur ta hapë urën.... nëse e lënë. Për kasnec apo tellall të këtij lajmi e zgjodhi Komandant Mefin që ka një zë kumbues sikur Bilalli kur e thërriste ezanin në kohën e Profetit Muhamet. Thonë se historia në të shumtën e rasteve përsëritet si farsë, në rastin tonë kemi përsëritje origjinale kur kanë sulmuar fizikisht dhe gojarisht Bilallin dhe Profetin Muhamet për shkak të bindjeve që i shpërndanin te të paudhët. Edhe sot po sulmohen kasneci Mefi dhe profeti i LVV - së, Albin Kurti shkaku i bindjeve se janë në të drejtën e tyre që ta hapin urën mbi lumin Ibër. Nga aspekti logjik dhe të së drejtës plotësisht kanë të drejtë dhe duhet të përkrahen nga të gjithë, sidomos nga të paudhët e që është opozita sipas LVV - së. Të paudhë konsiderohen edhe gazetarët dhe individët që nuk janë në dashuri me Albinin dhe... Dejonën. Të paudhët janë edhe këta burokratët e BE - së, imperialistët amerikanë dhe revizionistët shqiptarë, me Edi Ramën në krye. Albini po hecë në maje të gishtërinjve mbi urën, si të ishte balerin i Bolshoje Teatrit, si Robert Nurejevi. Për të mos rënë

në ndonjë m..inë, si pararojë po i dërgon komandantët e shquar të UÇK - së, komandant Morrin dhe komandant Pleshtin, Cenin dhe Xhelën, të njohur për luftën e lavdishme, deri në zbythje taktike, në luftën e fundit. Opozita apo, të paudhët sipas LVV, nuk kanë asnjë qëndrim, qoftë personal, qoftë opozitar. Duan të hapet ura me lejen e miqve ndërkombëtarë kur pikërisht këta miq e krijuan këtë situatë. Opozita mendon që ndërkombëtarët mund dhe duhet të përdoren si trup votues dhe për rrëzim të Albin Kurtit e që sipas meje nuk ndodhë, as e para e as e dyta. Opozita është krejtësisht impotente, pa qëllim dhe pa veprim. Nuk shtrohet fare dilema nëse ura duhet të hapet, ajo duhet të hapet. Problemi që unë e shoh të pakapërcyeshëm është se nuk ka kush ta mbrojë hapjen e urës, dezertorët Sfeçla dhe Durmishi nuk e bëjnë dot, komandant Mefi, përkundër përmasave gjigante anatomike, për lirinë e Kosovës nuk e ka shkrepe as edhe një pordhë të vetme për ta bërë një vetëflim mbi këtë urë. Më parë ka të ngjarë që urën mbi lumin Ibër ta hapë Milladini., se Albini. Po thonë se Albini urën po e përdorë për vota, para zgjedhjeve. Ani çka, le ta hapë, le ta mbrojë dhe le të fitojë vota por, mos të luaj k..e me urën e pastaj të kërkojë ndihmë dhe mbrojtje nga KFOR-i. Është e qartë se "manekinet e urës së Ibër", nëse vjen puna pisk, jo që nuk do ta mbrojnë urën mbi lumin Ibër por as Kryeveprën e Tyre Arkitektonike, Urën e Staradranit për të cilën kanë shpenzuar shumë para dhe kanë derdhur shumë djersë. Këta nuk kanë se derdhin gjak për mbrojtje të urës, nuk kanë derdhur gjak as për Kosovën, madje nuk kanë derdhur gjak as në Institutin për Transfuzion të Gjakut shkaku se nga Kosova vetëm kanë marrë dhe përfituar, pa i dhënë asgjë! Prandaj, nuk keni çka të kërkoni te ura, o të paburra!

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Fillon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 12 GUSHT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se është hapur afati kalimtar në basketboll te meshkujt dhe

femrat. "Afati kalimtar është hapur sot (12 gusht) dhe do të zgjasë deri më 23 gusht për lojtarët/et vendorë/e dhe të huaj/a në të dyja

konkurrencat", thuhet në njoftimin e FBK-së. Edicioni i ri pritet të jetë mjaft interesant. Klubet kanë filluar përgatitjet dhe përforcimet

për edicionin 2024-25. Klubet pritet të jenë mjaft aktive në afatin kalimtar, duke marrë parasysh edhe synimet që kanë për edicionin e ri.



Queven shkëlqeu ndaj Dukagjinit, rrëmben çmimin 'Ylli i javës'



"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 GUSHT - Edicioni i ri i futbollit në Albi Mall Superligë ka filluar në fundjavë, kurse Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, edhe në këtë edicion do të vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës".

Për javën e parë ky çmim në elitë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Queven Da Silva Inacio. Për xhiron e parë vlerësimin e më të mirit e ka bërë komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Avni Shala, Shyqri

Salihu dhe Lulzim Berisha. Komisioni në fjalë vendosi që ky çmim t'i jepet Inacios, pasi ai realizoi dy gola, duke qenë më meritori që Ballkani nisi edicionin e ri me fitore ndaj Dukagjinit të Klinës (2-0).

Pasi mori këtë çmim, Da Silva Inacio u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës. "Së pari do të doja ta falënderoja Zotin për këtë mundësi që të jem këtu dhe ekipin tim, sepse pa ata asgjë nga kjo nuk do të ishte e mundur. Po punojmë shumë për ta arritur qëllimin tonë. Kemi ligën që ka nisur dhe qëllimi ynë është të bëhemi sërish kampionë. Jam

shumë i lumtur që jam këtu dhe përfaqësoj Ballkanin, këtë ekip të madh që ka një peshë të madhe në futbollin e Kosovës", ka thënë Da Silva përfaqësues zyrtarë të FFK-së. "Do të luftojmë deri në fund dhe do të punojmë gjithmonë për të qenë në majë. Në lidhje me trofeun, jam shumë i lumtur. Pas një kohe të gjatë që shumë gjëra ndodhën me mua. Shumë njerëz nuk e dinë, por kam kaluar kohë të vështira. Por Zoti është i madh dhe ai di gjithçka. Prandaj, jam mirënjohës për gjithçka dhe puna nuk ndalet", ka shtuar Queven Da Silva Inacio.

Rrahmani pas transferimit në Greqi: Dua të fitoj përvojë dhe të kontribuoj për Kosovën

PRISHTINË, 12 GUSHT - Basketbollistja e Kosovës Agnesa Rrahmani është transferuar në Greqi te skuadra e Athinaikos. Ky është një hap para për basketbollisten e Kosovës, derisa Rrahmani ka përfaqësuar Kosovën edhe në garat e 3x3. Athinaikos bën gara në Divizionin A2 apo Ligën e Parë Greke. Agnesa është shprehur shumë e lumtur për këtë transferim. "Është një përvojë e re në basketbollin evropian. Kjo do të thotë shumë për mua, sidomos për mua në këtë moshë që të fitoj përvojë dhe të kontribuoj për Kosovën. Mezi po e pres këtë rrugëtim", ka thënë Rrahmani përfaqësues zyrtarë të FBK-së. Rrahmani është pjesë e Kosovës A dhe Kosovës 3x3. Ajo ka luajtur për grupmoshat e Kosovës. "Të luash për Kosovën është



gjithmonë nder dhe krenari, por edhe ndihmë e madhe, pasi je në vëzhgim të agjentëve të ndryshëm. Gjithmonë kam luajtur me krenari dhe përgjegjësinë më të madhe për Kosovën", ka shtuar tutje basketbollistja nga Ferizaj.

Së fundi ka qenë pjesë e skuadrës Peja 03, kurse më parë ishte pjesë e Prishtinës dhe Kastriotit. Athinaikos është formuar në vitin 1917. Nga 2008 deri më 2012 fitoi katër herë titullin në Greqi dhe tri herë Kupën. Më 2010 fitoi edhe Eurokupën.

Kosova përgëzohet për medaljet olimpike në 'Paris 2024'

PARIS, 12 GUSHT - Federata Ndërkombëtare e Xhudos dhe Federata Evropiane e Xhudos i kanë dërguar urimet e tyre zyrtare për suksesin e Kosovës në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Federata Ndërkombëtare e Xhudos e ka uruar kryetarin e Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka, për fitoret e dy medaljeve olimpike.

"Puna dhe aftësia juaj e palodhur kanë bërë që të fitoni 1 medalje të argjendtë dhe 1 të bronzit për Kosovën gjatë Lojërat Olimpikë Paris 2024. Shpresojmë që këto arritje të frymëzojnë brezin e ri, duke shërbyer si modele dhe duke kontribuar në zhvillimin dhe njohjen e xhudos në mbarë botën", thuhet në letrën zyrtare nga presidenti Marius L. Vizer,



drejtori i përgjithshëm Vlad Marinescu dhe sekretarja e përgjithshme Lisa Allan të Federatës Ndërkombëtare të Xhudos. Edhe presidenti i Federatës Evropiane të Xhudos, Laszlo Toth, ka përgëzuar Federatën e Xhudos së Kosovës për arritjet e suksesshme në olimpiadë këtë vit.

Valiev pas medaljes olimpike: Shpresoj që tani të bëhen traditë

TIRANË, 12 GUSHT - Shqipëria i shijoi medaljet e para olimpike në histori të saj falë sportit të mundjes. Mundësi Chermen Valiev ishte një prej sportistëve që iu sollti medalje të bronzit kuqezinjve në "Paris 2024". 25-

vjeçari në rrjetet sociale u shfaq mjaft i lumtur që është futur në histori si medalisti i parë kuqezi, ndërsa shpreson që medaljet olimpike të bëhen traditë për Shqipërinë. "Ju faleminderit shumë për të

gjithë mesazhe dhe urimet! E ndiej vërtet mbështetjen tuaj. Gjithashtu dua t'i falënderoj të gjithë ata që morën pjesë në fitoren time, të cilët janë trajnerët e mi, familja ime, si dhe një falënderim të madh për

Federatën Shqiptare të Mundjes. Unë pata fatin t'ju sjell medaljen e parë historike. Shpresoj që kjo të bëhet traditë dhe nga çdo olimpiadë e radhës skuadra shqiptare të kthehet me medalje", ka thënë Valiev.



Manaj 'tremb' Sivassporin: Nuk e di nëse do të qëndroj

Sivas, 12 gusht - E ardhmja e Rey Manaj mbetet një rebus edhe pse nga fundi i merkatos na ndajnë shumë pak ditë. Sulmuesi shqiptar ka nisur sezonin e ri me Sivassporin, ku luajti për 90 përballë Trabzonsporin, por ende nuk dihet nëse do të jetë pjesë e

skadërës në fjalë për shumë kohë. Sulmuesi ka konfirmuar pas ndeshjes se bisedimet vazhdojnë dhe ekziston mundësia që ai të nisë një aventurë të re në një tjetër skuadër. Në prononcimin pas sfidës, Manaj ka zbuluar se klubi është në bisedime për

shitjen e tij por, në anën tjetër, sulmuesi zbulon se edhe nëse qëndron në Sivas, ai do të jetë po aq i lumtur, pasi është një klub që atij i ka dhënë shumë dashuri. "Kemi pasur takime me klubin sa i takon situatës së transferimit. Mund të them se gjithçka është ende në zhvillim.

Nuk e di nëse do të largohem apo do të vijoj të jem pjesë e Sivassporit. Unë e dua shumë Sivasin. Jam trajtuar gjithmonë shumë mirë këtu. Nëse do të jetë e mundur që të vazhdoj, sigurisht që do të qëndroj", ka thënë Manaj, i cili edicionin e kaluar ka qenë shënuesi i tretë



më i mirë i kampionatit, pas Mauro Icardit dhe Edin Dzekos.

Amerikanët rrëmbejnë më së shumti medalje në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

PARIS, 12 GUSHT - Të dielën mori fund edicioni i sivjetmë i Lojërave Olimpikë, "Paris 2024". Në ditën e fundit amerikanët arritën të dalin në krye të tabelës me 40 medalje të arta, po aq sa patën kinezët të cilët kishin udhëhequr pothuajse gjatë gjithë kohës. Mirëpo, numri i medaljeve të argjendta, 44, bëri që ShBA-ja ta kalonte Kinën në renditje. Ata gjithsej patën 126 medalje (përfshirë 42 të bronzit), teksa kinezët gjithsej 91, 27 të argjendta dhe 24 të bronzta. Në vendin e tretë erdhi Japonia me 20 të arta, 12 të argjendta, 13 të bronzta, dhe 45 gjithsej. Australia doli e katërta me 18 të arta, 19 të argjendta dhe 16 të bronzta - 53 gjithsej. Nikoqirja, Franca, mblodhi 16 të arta, 26 të argjendta, 22 të bronzta - gjithsej



64. Holanda pati 15 medalje të arta, shtatë të argjendta dhe 12 të bronzta - gjithsej 34. Britania e Madhe numëroi 14 medalje të arta, 22 të argjendta dhe 29 të bronzta - gjithsej 65. Koreja e Jugut fitoi 13 të arta, nëntë të argjendta dhe dhjetë të

bronzta - gjithsej 32. Italia shkoi në shtëpi me 12 të arta e 132 të argjendta, e 215 të bronzta - gjithsej 40. Topdhjetëshen e mbylli Gjermania me 12 të arta, 13 të argjendta dhe tetë të bronzta - gjithsej 33.

Antonelli: Nuk më frikëson ideja për të drejtuar një Mercedes

SHITUATGART, 12 GUSHT - Kampionati Botëror i vitit 2025 në Formula 1 do të shohë George Russell në timonin e Mercedesit, por emri i shokut të skuadrës së britanikut për sezonin e ardhshëm nuk është zyrtarizuar ende. Indikacionet e fundit tani duket se çojnë në një njoftim të pilotit të ri italian Kimi Antonelli, i cili do të bëjë debutimin e tij në moshën 18-vjeçare në Formula 1 (aktualisht garon në Formula 2). Shumë, duke përfshirë drejtorin e ekipit të Mercedesit, Toto Wolff, kanë krahasuar cilësitë e talentit të ri italian me ato të kampionëve të tjerë të mëdhenj të Cirkut, duke filluar nga Max Verstappen. Deklarata që mund të gjenerojnë një nivel të caktuar tensioni, veçanërisht nëse pritet nuk përmbushen. "Mendoj se ka gjithmonë një shkallë të caktuar shqetësimi, nga ideja se mos i zhgënjëj të gjithë. Gjithsesi, unë dua ta shoh atë si një mundësi të shkëlqyer për të mësuar, rritur dhe gjithashtu shijuar momentin. Nuk kam frikë të gjykohej. E di që Mercedesi ka një mendim të qartë



për potencialin tim", ka thënë Kimi Antonelli. "Tashmë, në këtë sezon të Formulës 2, kampionati nuk nisi në mënyrën më të mirë, por nuk pati mendime negative. Jam mjaft i qetë dhe nëse do të më paraqitej mundësia, do ta shfrytëzoja me entuziazëm dhe do të përpiqesha ta

shfrytëzoja sa më shumë", ka thënë piloti italian. Mundësitë në F1 që Mercedesi ia ka paraqitur tashmë Antonellit me kryerjen e testeve private, në fund të të cilave talenti italian është lidhur gjithnjë e më shumë me Mercedesin për vitin 2025. "Ka pasur pak presion mbi mua kohët e fundit me të gjitha thashethemet për vitin e ardhshëm, por gjithmonë jam përpjekur t'i shijoj të gjitha dhe po i shijoj mundësitë që kam", ka shtuar Antonelli. "Gjatë testeve parasezonale në Bahrein pata mundësi të pilotoj makinën dhe në atë moment i thashë vetes: 'Epo, ti do të ngasësh një makinë të Formula 1'. Ishte një moment shumë, shumë i veçantë", u shpreh Kimi Antonelli. Në fund, ai ka deklaruar: "Jam i vetëdijshëm që marzhi i gabimit është shumë i vogël, por sa më shumë besim të kem me makinën, aq më rehat ndihem. Unë ende e shoh atë si një ëndërr. Me gjithë sinjeritet mund të them se për mua sot është ende një ëndërr, do të shohim nëse do të bëhet realitet".

SHKURT

Stuttgarti, gati ta rrëmbejë Brojën

Sulmuesi Armando Broja ka përfunduar në ekipin e të rinjve tek Chelsea, duke e detyruar që tashmë ta nisë kërkimin për një skuadër të re. Për 22-vjeçarin ka dalë në skenë një ofertë interesante nga Stuttgarti në Bundesligë. "Sky Sport De" ka raportuar se Stuttgarti ka nisur zyrtarisht negociatat me Chelsea dhe është duke kërkuar huazimin e Brojës. Stuttgarti është një mundësi shumë interesante, pasi do të jetë në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve. Ende nuk ka një përgjigje nga Chelsea, që më herët refuzoi një shumë prej 32 milionë eurosh nga Evertoni për sulmuesin kuqezi. Pritet që kjo javë të jetë vendimtare për të ardhmen e Brojës, pasi ka interesim edhe nga Juventusit dhe Milani në Itali.

Roma e dëshiron Zhegrovën në vend të Dybalas

Ylli i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, mund të transferohet në Serinë A. Pas Milanit, garës për transferimin e Zhegrovës i ka hyrë edhe Roma. "Corriere della Sera" raporton se Zhegrova shihet si zëvendësues i Paulo Dybalas. Sulmuesi argjentinas e ka marrë një ofertë të çmendur nga Arabia Saudite: dy vjet kontratë me 20 milionë euro rrogë në vit në klubin e kontrolluar nga fondi PIF. Në rast se ish-futbollisti i Palermos e Juventusit përfundon në Saudi Pro League, atëherë do t'i hapet rruga futbollistit të Lille të përfundojë në kryeqytetin italian. 25-vjeçari është sot një prej futbollistëve më të mirë shqiptarë, ndërsa ofertat për të nga Anglia, Italia, Spanja e Gjermania nuk kanë munguar në vitet e fundit.

Sergi Roberto pas 14 sezonesh largohet nga Barcelona

Sergi Roberto është larguar nga Barcelona pas 14 sezonesh. Kontrata e 32-vjeçarit skadoi në fund të qershorit, por deri më tani nuk ishte marrë asnjë vendim për të ardhmen e tij. Roberto hyri në akademinë e Barçës në La Masia dhe bëri debutimin e tij me ekipin e parë në 2010. "Pas 373 ndeshjeve, 25 trofeve dhe një goli të paharrueshëm, futbollisti që mbërriti në La Masia në moshën 14-vjeçare po largohet nga klubi", thuhet në një deklaratë të Barcelonës. Sergi Roberto shënoi 19 herë për Barcelonën dhe fitoi dy Liga të Kampionëve dhe shtatë tituj të La Ligës, mes fitoreve të tjera.

Aston Villa, gati 60 milionë për Felix

Joao Felix mund ta shohim në Premierë Ligë në sezonin e ri. Sulmuesi portugez u rikthye tek Atletico Madridi pas huazimit të Barcelona pavarësisht dëshirës së tij të madhe për të vijuar me katalanasit. Karriera e 24-vjeçarit pritet të vazhdojë në Premierë Ligë, aty ku e kërkon Aston Villa, skuadër që sezonin e ri do të garojë në grupet e Ligës së Kampionëve. Klubi nga Birminghami po përgatit një ofertë prej 60 milionë eurosh, aq sa është edhe shumë që pretendon Atletico për ta lënë të lirë portugezin. Joao Felix është shndërruar në objektivin e madh të Aston Villas dhe teknikut Unai Emery. Me spanjollin që e cilëson si zëvendësuesin perfekt të Moussa Diaby. I shitur në Arabinë Saudite tek Al-Ittihad për 60 milionë euro.

Tronditet Napoli, Chelsea kërkon 43 milionë euro për Lukakun

E ardhmja e Romelu Lukakut është ende e paqartë, edhe pse largimi i tij nga Chelsea është më se i sigurt. Sulmuesi belg ka oferta të shumta kryesisht nga Arabia Saudite, por ai ka refuzuar të

transferohet në Lindjen e Mesme. Aston Villa ka arritur marrëveshje me Chelsea, por belgu ka refuzuar edhe transferimin në Villa Park pasi dëshira e tij e vetme është Napoli. Lukaku dëshiron të

rikthehet në Itali pas një viti të kaluar si i huazuar te Roma dhe tanimë i ka dhënë fjalën trajnerit Antonio Conte se do t'i bashkohet te Napoli. Megjithatë Chelsea nuk po heq dorë lehtë për Lukakun,

pasi tanimë i ka bërë të qartë Napoli se nëse e duan sulmuesin belg duhet të paguajnë 43 milionë euro. "Calciomercato" ka raportuar se kërkesat e Chelsea për Lukakun kanë tronditur

drejtuesit e Napolit. Megjithatë dy klubet po vazhdojnë bisedimet dhe mund të arrihet një marrëveshje, pasi Chelsea po kërkon transferimin e Victor Osimhen nga Napoli.



Kompania Regjionale e Mbeturinave
Regjionale Kompania za Ukljanje Qytada
"PASTRIMI" sh.a. d.d.
Nr. br. 4434 dt. 12.08.2024
Prishtinë - Pristina

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPI Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 09.08.2024 me numër të protokollit 4402 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

Titulli i vendit të Punës: "Përgjegjës i Ndrimit në Kontrollë Interne" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë,

Departamenti: Drejtoria e Operativës

Numri i Referencës: DO/KJ-11/2024

Koeficienti/Paga mujore: Niveli IX

Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar,

Periudha Provuere: 3 muaj

1. Detvat dhe Përgjegjësitë:

- Mbikëqyrë punën e kontrolles interne operative, në aspektin e përcjelljes së ecurisë së punës në Kompani gjatë ndrrimit të tij;
- Mbanë evidenc dhe pregadit raport të punës për çdo keqpërdorim apo parregullsi eventuale që dëmton interesin dhe imazhin e kompanisë dhe e njofton Udhëheqësinë menjëherë;
- Mbanë evidencë nga Kontrollorët për shoferët dhe njësitë e bartjes së kompanisë në çdo kohë dhe në çdo vend gjatë ndrrimit të tij.
- Harton dhe zbaton strategjinë e kontrollimit të saktë të shpenzimeve të karburanteve dhe lubrifikantve në kompani, të përcaktoj treguesit dhe parametrat matës të shpenzimeve për çdo kamion-automjet dhe ta njoftoj Udhëheqësin.
- Raporton keqpërdorimet eventuale të drejtës në pushim mjekësor të të punësuarve dhe e njofton Udhëheqësin.
- Mbanë librin e punës të cilin evidencon, inspektimet, vërejtjet dhe veprimet e ndërmarra dhe të benë përpunimin analitik të të dhënave, të cilat mund të shërbejnë si dëshmi materiale në raste të keqpërdorimeve eventuale, të siguroj se të gjitha raportet dhe të dhënat e paraqitura nga fushëveprimi i inspektimit të tij janë të sakta dhe në përputhje me gjendjen reale të cilat në rast kontesti do të argumentoj dhe duhet të dërgoj tek Udhëheqësi.
- Raporton me shkrim çdo javë Udhëheqësi për punën e tij dhe të stafit të kontrollës gjatë ndrrimit të tij.
- Për çdo parregullsi – keqpërdorim njofton Udhëheqësin
- Përgatit raporte të rregullta dhe i raporton Udhëheqësit të Njesisë;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga Udhëheqësi të Njesisë
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqës i Njesisë së Kontrollës Interne Operative

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë Universitare
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 3 vite përvoja pune

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,

- Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirueshme).
- Kopje të Letërnyfimit,
- Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e përmblylljes së Konkursit të Brendshëm:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 13.08.2024 deri me datën 27.08.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejtë njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

10. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 27.08.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistes deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Anton Gjogaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12 të Gjimnazit Hjarad Dushi" Gjakovë.

- Asllan Maloki nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m. Teknike Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



Kompanija Regionalne e Mbetuarine
Ekipa e kompanija za ushtimime QK 2024
"PASTRIMI" sht.a. d.d.
Nr. br. 44/34 dt. 12.08.2024
Prishtine - Prishtine

REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD „PASTRIMI“ a.d

Na osnovu Zakona br. Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8 Administrativnog uputstva MFPT br. 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, konkretno član 5 stav 1,2 i član 7 Uredbe br. 01/2024 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta u KRM „Pastrimi“ S.A., Rešenjem od 09.08.2024.godine sa protokolom broj 4402 glavnog izvršnog direktora KRM „Pastrimi“ S.A., saopštava se:

UNUTRAŠNJE TAKMIČENJE (Da popuni radno mesto)

Naziv radnog mesta: „Odgovornik za promene interne kontrole“ u KRM „Pastrimi“ dd (1 pozicija),

Odeljenje: Direkcija za operacije
Referentni broj: DO/KJ-11/2024

Koeficijent/mesečna zarada: Nivo Nivo IKS
Trajanje ugovora o radu: na neodređeno vreme,
Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- vrši nadzor nad radom interne operativne kontrole, u smislu praćenja toka rada u Preduzeću tokom njegove promene;
- Vodi evidenciju i priprema izveštaj o radu za svaku eventualnu zloupotrebu ili nepravilnost koja šteti interesu i imidžu kompanije i odmah obavesti Upravu;
- Vodite evidenciju od kontrolora za vozače i transportne jedinice kompanije u bilo koje vreme i na bilo kom mestu tokom njegove smene.
- Osmišljava i sprovodi strategiju tačne kontrole troškova goriva i maziva u preduzeću, da odredi indikatore i merne parametre troškova za svako kamion-vozilo i obavesti Lidera.
- Prijavljuje potencijalne zloupotrebe prava zaposlenih na bolovanje i obaveštava rukovodioca.
- Vodi radnu knjižicu u koju se evidentiraju pregledi, zapažanja i preduzete radnje i vrši analitičku obradu podataka, koji mogu poslužiti kao materijalni dokaz u slučajevima potencijalne zloupotrebe, kako bi se osiguralo da svi izveštaji i podaci izneseni iz delokruga njegovog inspekcijuskog nadzora su tačni i u skladu sa realnom situacijom koje ću u slučaju spora argumentovati i moram poslati Vođi.

- Svake nedelje pismeno izveštava vođu o svom radu i radu kontrolnog osoblja tokom njegove smene.
- Za svaku nepravilnost - zloupotrebu obavestiti Vođu
- Priprema redovne izveštaje i izveštaje načelniku Odeljenja;
- Obavlja poslove i druge poslove u vezi sa opisom poslova koje zahtevaju rukovodioci jedinica
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac Jedinice operativne unutrašnje kontrole

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

Da ste državljanin Republike Kosovo,
Da ima punu sposobnost za postupanje, u skladu sa zakonima na snazi;
Da vlada najmanje jednim od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
Biti sposoban da izvrši odgovarajući zadatak;
Da nije osuđivan za krivično delo;
Da ima obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i/ili veštine potrebne za poziciju
Da uspešno prođe prijemne procedure definisane ovim zakonom.

3. Opšti formalni zahtevi

Obavezna stručna sprema: univerzitetska diploma
Potrebno radno iskustvo: Najmanje 3 godine radnog iskustva

4. Znanje, veštine i kvaliteti potrebni u postupku zapošljavanja

Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
Komunikacione veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih sudova i diskrecionog prava o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politika;
Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenta koja se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

Popunjenu i potpisanu prijavu kandidata,
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove,
Kopija dokaza o zaposlenju (Penzijski fond, potvrda ili ugovor o radu),
Kopije dokaza o obuci i kursovima,
Kopije evaluacija rada za poslednje dve godine, (Poželjno).
kopije obaveštenja,
Uverenje da nije osuđivan za krivično delo ne starije od 3 meseca.

6. Kako se prijaviti na konkurs:

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvaničan formular u Službi za ljudske resurse KRM „Pastrimi“ S.A.

Sve prijave moraju biti podnete isključivo elektronski preko elektronske platforme; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Tačan datum i vreme završetka Internog takmičenja;

Interni konkurs traje 15 dana od 13.08.2024 do 27.08.2024. Rok za prijem prijava je 16.00 časova. Sve prijave pristigle nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Način vrednovanja i kriterijumi bodovanja.

Ocenjivanje kandidata vrši se na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test). Biografija kandidata se ocenjuje do deset (10) bodova, pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) poena, Intervju (usmeni test) vrednuje se do dvadeset (20) bodova.

Postupak ocenjivanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost ostvarenje najmanje pedesetpet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

Interni konkurs je otvoren do 27.08.2024.

Faza preliminarne verifikacije prijava do 7 dana,

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjua do 7 dana od objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gashi Fasader” SH.P.K. me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812020246 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gashi Fasader” D.O.O. Prizren, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812020246 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gashi Fasader” L.L.C. with headquarters Prizren, has come to the decision to quit its business: 812020246 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

